REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 2148 **_prot** **Libohovë më** 06 **.10.2026**

VENDIM

Nr. 52 , Datë 29 .09.2026

MBI
NDRYSHIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË LIBOHOVË PËR VITIN 2026
PËR MARRJEN E MASAVE PARANDALUESE NDAJ PËRMBYTJEVE

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor", I ligjit nr/45/2019 "për Mbrojtjen Civile ," i ndryshuar , Këshilli i Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës 29.09.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,pasi morri në shqyrtim relacionin nga Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar për rishperndarjen e fondeve sipas nevajave nëpër programe :

VENDOSI:

I.Të miratojë ndryshimin e buxhetit të bashkisë për 2026.

- **PAKËSOHET:**

✓ **Gr.00, Kap. 05, Tit. 4980 , Artik. 609,Emergjencat Civile me vlerën1,095,612 lekë (një milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë)**

- **SHTOHET:**

✓ **Gr.00, Kap. 05, Tit. 6260 , Artik. 602, Nënart.6025 "Blerjen e Tubave prej betoni , Korogato , Hekur për Zgara , për marrjen e masave parandaluese ndaj përmbytjeve " me vlerën 1,095,612 (një milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë)**

II. Ngarkohet struktura përgjegjëse për prokurimin publik për ndjekjen e procedurave të prokurimit/blerjes së mallrave dhe shërbimeve të përcaktuara në preventiv.

III. Ngarkohet Komisioni i Emergjencave Civile për ndjekjen e realizimit të ndërhyrjeve të parashikuara dhe dokumentimin e përdorimit të fondit.

IV. Ngarkohet Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar për kryerjen e ndryshimeve përkatëse në buxhet dhe regjistrimin e tyre në sistemin financiar.

V.Ky vendim hyn në fuqi sipas pikes 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 :Për vetëqeverisjen Vendore",pas miratimit të tij nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

SEKRETARI I KËSHILLI
Rahim Skënderi

KRYETARI I KËSHILLIT
Asim Banushaj

Miratuar me 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Pro : 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnnjë
Vota Abstenim :asnjë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI I BASHKISË LIBOHOVË

PROJEKT VENDIM

Nr.2059 Prot

Libohovë, më 24.09.2026

Nr. _____, Datë_____.____.2026

MBI
NDRYSHIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË LIBOHOVË PËR VITIN 2026
PËR MARRJEN E MASAVE PARANDALUESE NDAJ PËRMBYTJEVE

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor",Ligjin nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", i ndryshuar , Këshilli i Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës 29.09.2026 me propozim të Kryetarit të Bashkisë,pasi morri në shqyrtim relacionin nga Sektori i Financës dhe Menaxhimit Financiar për rishperndarjen e fondeve sipas nevojave nëpër programe:

VENDOSI:

Të miratojë ndryshimin e buxhetit të bashkisë për 2026.

- **PAKËSOHET:**

✓ **Gr.00, Kap. 05, Tit. 4980 , Artik. 609,Emergjencat Civile me vlerën1,095,612 lekë (një milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë)**

- **SHTOHET:**

✓ **Gr.00, Kap. 05, Tit. 6260 , Artik. 602, Nënart.6025 "Blerjen e Tubave prej betoni , Korogato , Hekur për Zgara , për marrjen e masave parandaluese ndaj përmbytjeve " me vlerën 1,095,612 (një milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë)**

Për zbatimin e këtij vendimi :

1. Ngarkohet struktura përgjegjëse për prokurimin publik për ndjekjen e procedurave të prokurimit/blerjes së mallrave dhe shërbimeve të përcaktuara në preventiv.

2. Ngarkohet Komisioni i Emergjencave Civile për ndjekjen e realizimit të ndërhyrjeve të parashikuara dhe dokumentimin e përdorimit të fondit.

3. Ngarkohet Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar për kryerjen e ndryshimeve përkatëse në buxhet dhe regjistrimin e tyre në sistemin financiar.

4. Ky vendim u shpall sot më datë ___.___.2026 dhe hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

JURIST
Kristaq Ciko

SHEF.SEK FINANICAR
Joana Memo

KRYETAR
Leonard Hide

REPUBLIKA E SHQIPËRI SË
BASHKIA LIBOHOVË

SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

RELACION

Të nderuar këshilltar!

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, si dhe të UMF plotësues nr. 6/1, datë 28.02.2018 "Për përgatitjen e buxhetit vendor",

Ky relacion hartohet në mbështetje të kërkesës së Komisionit të Emergjencave Civile, me shkresë nr. 2004/1 prot., datë 18.09.2026, për marrjen e masave parandaluese ndaj përmbytjeve në disa pika problematike të territorit të Bashkisë Libohovë.

Gjatë periudhës së dimrit, si pasojë e reshjeve të dendura, në disa zona të territorit të Bashkisë Libohovë janë evidentuar problematika të lidhura me grumbullimin dhe përqendrimin e ujërave, duke shkaktuar përmbytje dhe vështirësi në qarkullimin e banorëve dhe mjeteve.

Në disa pika, përrenjtë dhe rrjedhat ujore përshkohen nga mjete motorike dhe në këmbë, ndërkohë që mungojnë veprat e përshtatshme për kalimin e ujërave. Këto problematika paraqesin rrezik për ndërprerjen e komunikimit, dëmtimin e rrugëve dhe krijimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën dhe sigurinë e banorëve.

NEVOJA PËR NDËRHYRJE

Për sa më sipër, Komisioni i Emergjencave Civile vlerëson të domosdoshme marrjen e masave parandaluese dhe paraprake përpara fillimit të periudhës së reshjeve të dendura.

Ndërhyrjet konsistojnë kryesisht në:
vendosjen e tubave/tubinove prej betoni në pikat problematike;
vendosjen e zgarave të hekurit në pikat e identifikuara;
krijimin e kalimeve të sigurta për ujërat;
garantimin e qarkullimit të banorëve dhe mjeteve;
minimizimin e dëmeve të mundshme nga reshjet e dendura;
realizimin e ndërhyrjeve parandaluese përpara krijimit të situatave emergjente.

Këto masa janë të karakterit parandalues dhe synojnë reduktimin e pasojave që mund të shkaktohen nga reshjet e dendura dhe përmbytjet.

Për realizimin e ndërhyrjeve të mësipërme është përgatitur preventivi paraprak i shpenzimeve, i cili është pjesë e dokumentacionit bashkëlidhur.
Vlera e kërkuar për financimin e këtyre ndërhyrjeve është:
1.095.612 lekë me tvsh .
Në funksion të sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak të miratojë projekt-vendimin , I cili do të mundësojë fillimin në kohë të procedurave të nevojshme dhe realizimin e ndërhyrjeve përpara periudhës së reshjeve të dendura.

BASHKËLIDHUR:
1.Shkresa e Komisionit të Emergjencave Civile, nr. 2004/1prot., datë 18.09.2026;
2.Procesverbali për verifikimin në terren;
3.Preventivi paraprak i shpenzimeve.

Shef.Sekt Zhvillimi Ekonomik dhe Menaxhimi Financiar
Joana Memo

KOMISIONI I EMERGJENCAVE

1. **Gazment Culla** – Antar
2. **Xhelili Tusuni** – Kryetar
3. **Llazar Mekshi** – Anëtar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KOMISIONI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr.2004 Prot.

Libohovë, më 18.09.2026

PROCESVERBAL

Për verifikimin në terren të pikave problematike dhe marrjen e masave parandaluese ndaj përmbytjeve

Sot, më datë 18.09.2026, në territorin e Bashkisë Libohovë, u krye verifikimi në terren nga Komisioni i Emergjencave Civile, i ngritur me Urdhrin nr.12, datë 16.01.2026 të Kryetarit të Bashkisë Libohovë.
Në përbërje të grupit të verifikimit ishin:
Z. Xhelil Tusuni – Kryetar i Komisionit
Z. Gazmend Çulla – Anëtar
Z. Llazar Meksi – Anëtar

Qëllimi i verifikimit
Verifikimi në terren u krye me qëllim evidentimin e pikave në të cilat, gjatë periudhës së dimrit të kaluar, si pasojë e reshjeve të dendura të shiut dhe prurjeve të mëdha të ujërave, janë krijuar problematika të cilat kanë sjellë përmbytje, dëmtime të rrugëve dhe vështirësi në kalimin e banorëve dhe mjeteve.
Gjatë verifikimit u konstatua se në disa pika të territorit të bashkisë, rrjedhat ujore kalojnë mbi ose pranë rrugëve të përdorura nga banorët dhe mjetet, ndërsa mungojnë kalime të përshtatshme për disiplinimin e ujërave.

Konstatimet në terren
Nga verifikimi u evidentuan këto pika problematike:
Nr.
Vendndodhja
Problematika e konstatuar
Ndërhyrja e nevojshme
Sasia e përafërt

Adresa: Lagjia "Linua" Libohovë,email- info@bashkialibohove.gov.al , Tel: 00355 881 220 91

1.
Lagjia Hoxhallarë, përroi I Lozës rruga që shkon në shtëpi Luan Beqo ka nevojë për tubo betoni 1000 pasi ato që ka ekzistuese janë dëmtuar dhe bllokohen pasi janë të vogla dhe nuk e përballojnë dot sasinë e ujit I cili kalon mbi të dhe përmbyt shtëpinë e Pandeli Ruçit dhe të Kujtim Ruçit.
Përqendrim i prurjeve dhe rrezik për përmbytje
Vendosje tumbino betoni
5 copë

2.
Lagjia Teqe Fushë Përoi I Zervoit rruga që shkon në shtëpi Vehab Shehu ka nevojë për tubo betoni 1000 pasi ato që ka ekzistuese janë dëmtuar dhe bllokohen pasi janë të vogla dhe nuk e përballojnë dot sasinë e ujit i cili ndevijon drejtimin dhe rezikohen të përmbyten disa familje në këtë lagje.
Përqendrim i prurjeve dhe rrezik për përmbytje
Vendosje tumbino betoni
5 copë

3.
Lagjia Teqe Fushë Përoi I Zervoit rruga që shkon në shtëpi Selaudin Maçi ka nevojë për tubo betoni 1000 pasi ato që ka ekzistuese janë dëmtuar dhe bllokohen pasi janë të vogla dhe nuk e përballojnë dot sasinë e ujit i cili ndevijon drejtimin dhe rezikohen të përmbyten dhe gryen tokat e disa familjeve në këtë lagje.
Dëmtim/erozion i rrugës dhe tokës nga ujërat
Vendosje tumbino betoni
5 copë

4.
Lagjia Teqe Fushë Përoi I Zervoit rruga që shkon në shtëpi Zane Peça ka nevojë për tubo betoni 1000 pasi ato që ka ekzistuese janë dëmtuar dhe bllokohen pasi janë të vogla dhe nuk e përballojnë dot sasinë e ujit i cili ndevijon drejtimin dhe rezikohen të përmbyten disa familje në këtë lagje.
Vështirësi në kalimin e mjeteve dhe banorëve
Vendosje tumbino betoni
5 copë

5.
Lagjia Teqe Fushë Përoi I Zervoit rruga që kalojnë banorët e kësaj lagjeje me këmbë për të ardhur në qendër të qytetit Libohovë si dhe fëmijët në shkolla, si dhe ku kalon me makinë për të shkuarnë shtëpi Sajde Peça, ka nevojë për tubo betoni 1000 pasi ato që ka ekzistuese janë dëmtuar dhe bllokohen pasi janë të vogla dhe nuk e përballojnë dot sasinë e ujit i cili devijon drejtimin dhe rezikohen të përmbyten disa familje në këtë lagje.
Vështirësi në kalimin e mjeteve dhe banorëve
Vendosje tumbino betoni
5 copë

6.
Në segmentin rrugor që të çon në fshatrat Zhej dhe Lliar janë 6 përrenj të cilat kanë nevojë për tubo betoni.Në pesë vende duhen tubo betoni 1000 dhe në një vend duhen tubo betoni 600
Rrezik përbllokim të komunikimit
Vendosje tumbino betoni
25 copë 1000
5 copë 600

7.
Në fshatin Nepravishtë në Qendër të fshatit kemi pasur shumë përmbytje të cilat kanë nevojë për tubo korogato 315 mm.
Vështirësi në kalimin e mjeteve dhe banorëve
Vendosje tumbino korogato
150 metra me përmasa 315mm

Totali i përafërt: 50 copë tumbino betoni 1000, 5 copë tumbino betoni 600 dhe 150 metra tubo korogato 315mm.
Nga verifikimi rezulton se ndërhyrja është e nevojshme për të orientuar dhe përçuar ujërat e reshjeve nëpërmjet tubave/tumbinove prej betoni, duke krijuar kalime të përshtatshme dhe duke reduktuar mundësinë e përmbytjes dhe dëmtimit të rrugëve.

Gjithashtu nevojitet hekur për sistemimin e pusetave të cilat si rezultat I prurjeve të shumta bllokohen dhe krijojnë përmbytje nga rreshjet e dendura. Përkatësisht janë 7 vende emergjente ku duhen zgara hekuri me përmasa 5 metra të gjata dhe 0.5 metra të gjera.
Gjithsej në total 35 metra me gjerësi 0.5 metra.

Nga verifikimi rezulton se ndërhyrja është e nevojshme për të orientuar dhe përçuar ujërat e reshjeve nëpërmjet tubave/tumbinove prej betoni, duke krijuar kalime të përshtatshme dhe duke reduktuar mundësinë e përmbytjes dhe dëmtimit të rrugëve.

Vlerësimi i Komisionit
Komisioni i Emergjencave Civile vlerëson se problematikat e evidentuara përbëjnë një rrezik potencial për përsëritjen e situatave të përmbytjeve dhe ndërprerjen e qarkullimit, veçanërisht gjatë periudhave me reshje të dendura.
Duke qenë se ndërhyrjet kanë karakter parandalues, është e nevojshme që ato të realizohen përpara fillimit të periudhës së reshjeve të dendura, me qëllim uljen e riskut dhe minimizimin e pasojave të mundshme.
Për sa më sipër, Komisioni vlerëson të domosdoshme blerjen e tumbinove/tubave prej betoni, Korogatove, si dhe hekurit në sasinë dhe përmasat që do të përcaktohen sipas gjendjes konkrete në secilën pikë, dhe vendosjen e tyre në vendet e evidentuara.

Këto ndërhyrje synojnë:
parandalimin e përmbytjeve;
disiplinimin e ujërave të reshjeve;
mbrojtjen e rrugëve nga dëmtimi dhe erozioni;
garantimin e kalimit të banorëve dhe mjeteve;
shmangien e ndërprerjes së komunikimit;
uljen e riskut për jetën dhe sigurinë e banorëve;
parandalimin dhe reduktimin e dëmeve materiale gjatë sezonit të ardhshëm të reshjeve.
Për këtë arsye, Komisioni propozon që për realizimin e këtyre masave të përdoret fondi i emergjencave civile, sipas procedurave dhe legjislacionit në fuqi.

KOMISIONI I EMERGJENCAVE CIVILE

Kryetari i Komisionit	**Anëtarë**	**Anëtarë**
Xhelil Tusuni	**Gazmend Çulla**	**Llazar Meksi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KOMISIONI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr.2004/1 Prot.

Libohovë, më 18.09.2026

KËRKESË:
Për blerjen e tubave (tumbinove) prej betoni,Korogato,Hekur për zgara për marrjen e masave parandaluese ndaj përmbytjeve

Drejtuar:
SEKTORIT TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
Bashkia Libohovë

Lënda: Kërkesë për blerjen e tubave/tumbinove prej betoni, Korogato, si dhe hekur për zgarat e rrugëve nga fondi i emergjencave civile, për marrjen e masave parandaluese ndaj përmbytjeve.

Në kuadër të përgjegjësive të Bashkisë Libohovë për marrjen e masave për parandalimin dhe përballimin e situatave të emergjencave civile, si dhe në zbatim të detyrimeve për marrjen e masave parandaluese përpara shfaqjes së fenomeneve natyrore me rrezikshmëri, Komisioni I Emergjencave Civile paraqet këtë kërkesë për ndërhyrje në disa pika problematike të territorit të bashkisë.
Gjatë periudhës së dimrit të kaluar, si pasojë e reshjeve të dendura të shiut, në disa zona të territorit të Bashkisë Libohovë janë krijuar problematika të lidhura me grumbullimin dhe përqendrimin e ujërave, duke shkaktuar përmbytje dhe vështirësi në qarkullimin e banorëve dhe mjeteve.
Në disa pika, përrenjtë dhe rrjedhat ujore përshkohen nga banorët me mjete motorike dhe në këmbë, ndërkohë që mungojnë veprat e përshtatshme për kalimin e ujërave. Në kushtet e reshjeve të dendura, këto pika paraqesin rrezik për ndërprerjen e komunikimit, dëmtimin e rrugëve dhe krijimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën dhe sigurinë e banorëve.
Për këtë arsye, dhe duke qenë se jemi përpara sezonit të reshjeve, vlerësojmë të domosdoshme marrjen e masave parandaluese dhe paraprake, me qëllim shmangien ose minimizimin e pasojave të mundshme gjatë dimrit të ardhshëm.
Në funksion të kësaj, kërkojmë që Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat e nevojshme për:
Blerjen e tubave/tumbinove prej betoni, Korogato, si dhe hekur për zgarat e rrugëve në ato pika ku janë më problematike në sasinë dhe dimensionet që janë përcaktuar në preventivin bashkëlidhur;
Sigurimin e fondeve të nevojshme nga fondi i emergjencave civile, sipas procedurave dhe legjislacionit në fuqi;
Procedimin për prokurimin/blerjen e tyre në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe rregullat financiare;

Adresa: Lagjia "Linua" Libohovë,email- info@bashkialibohove.gov.al , Tel: 00355 881 220 91

Vendosjen e tubave si dhe sistemimin e zgarave të hekurit në pikat problematike të identifikuara në territorin e bashkisë, me qëllim krijimin e kalimeve të sigurta për ujërat dhe garantimin e qarkullimit të banorëve dhe mjeteve;
Marrjen e masave për realizimin e ndërhyrjeve përpara fillimit të periudhës së reshjeve të dendura, në mënyrë që të parandalohet përsëritja e problematikave të konstatuara gjatë dimrit të kaluar.
Kjo ndërhyrje vlerësohet si masë parandaluese për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të banorëve, garantimin e vazhdimësisë së komunikimit dhe minimizimin e dëmeve të mundshme nga përmbytjet dhe reshjet e dendura.
Bashkëlidhur, preventivi paraprak i tubave/tumbinove prej betoni, Korogatove, si dhe hekurit për zgarat e rrugëve të cilat janë të nevojshme dhe emergjente.
Duke vlerësuar rëndësinë dhe urgjencën e kësaj ndërhyrjeje, kërkojmë marrjen e masave përkatëse dhe fillimin e procedurave të nevojshme.

Bashkëlidhur:
Procesverbal për verifikimin në terren të pikave problematike dhe marrjen e masave parandaluese ndaj përmbytjeve

Preventivi paraprak i shpenzimeve.

KOMISIONI I EMERGJENCAVE CIVILE

Kryetari i Komisionit	**Anëtarë**	**Anëtarë**
Xhelil Tusuni	**Gazmend Çulla**	**Llazar Meksi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I SHËRBIMIT URBAN

PREVENTIV

BLERJE MATERIALESH PËR MARRJEN E MASAVE PARANDALUESE NDAJ PËRMBYTJEVE

INVESTITORI: BASHKIA LIBOHOVË
OBJEKTI: Blerje tubash/tumbinove dhe zgarash metalike për pikat problematike nga përmbytjet
HARTOI: SEKTORI I SHËRBIMIT URBAN

Nr.	Nr. Analizës	EMËRTIMI I ZËRIT	Njësia	Sasia	Çmimi (Lekë)	Vlera (Lekë)
1	1.34/p	Prodhim tuba b/a Ø1000 mm, t = 10 cm	ml	50.00	8,235.00	411,750.00
2	1.133/p	Tuba betoni Ø600 mm	ml	5.00	3,052.00	15,260.00
3	Ref. 3.164/1t	Tub i brinjëzuar HDPE SN8 d=315 mm - vetëm materiali	ml	150.00	1,100.00	165,000.00
4	1.111/p	Përgatitje zgara metalike të thjeshta	ton	1.68	191,071.00	320,999.28
SHUMA PA TVSH						**913,009.28**
TVSH 20%						**182,601.86**
SHUMA ME TVSH						**1,095,611.14**

SHËNIME:

1. *Preventivi përmban vetëm çmimet për blerjeje/prodhimi të materialeve; nuk janë përfshirë gërmime, montim, shtresa apo punime të tjera teknike.*
2. *Për Ø1000 është përdorur analiza e prodhimit 1.34/p. Për Ø600 është përdorur analiza 1.133/p.*
3. *Për tubin HDPE SN8 Ø315, analiza 3.164/1t është ze F.V.; në këtë preventiv është marrë vetëm komponenti material 'Tub HDPE SN8 d=315 mm' = 1,100 lek/ml, pa punë, rakorderi, rërë dhe materiale të tjera.*
4. *Për zgarat është përdorur analiza e prodhimit 1.111/p. Sasia e llogaritur: 7 zgara × rreth 240 kg/zgarë = 1.68 ton.*
5. *Procesverbali jep tubat Ø1000 dhe Ø600 në copë. Për preventivin sipas njësisë së Manualit është konsideruar 1 copë = 1.00 ml. Nëse gjatësia reale e elementit është tjetër, sasia në ml duhet korrigjuar.*

HARTOI
SEKTORI I SHËRBIMIT URBAN

Nelson Sejdo

Digitally signed by Nelson Sejdo
Date: 2026.09.18 09:16:26 +02'00'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 249 **_prot** **Libohovë më** 06 **.10.2026**

VENDIM

Nr. 53 , Datë 29.09.2026

PËR
RAPORTI I MONITORIMIT 8- MUJOR TË ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 68, date 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të UMFF plotësues nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte te programit buxhetor afatmesem te njesive te qeverisjes vendore" i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës 29.09.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

I.Të miratojë Raportin 8-mujor te Monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2026.

II.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë.

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas pikes 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 :Për vetëqeverisjen Vendore",pas miratimit të tij nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

SEKRETARI I KËSHILLI
Rahim Skënderi

KRYETARI I KËSHILLIT
Asim Banushaj

Miratuar me 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Pro : 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim :asnjë

Adresa: Lagjia "Lidas" Libohovë. email-bashkialiboh[illegible]ve@outlook.com, Tel: 00355 881 220 91

Nr 2064 Prot
[illegible].09.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI I BASHKISË LIBOHOVË

PROJEKTVENDIM

NR _____, DATË .09.2026

PËR
RAPORTI I MONITORIMIT 8- MUJOR TË ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR VITIN 2026

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të UMFE plotësues nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte te programit buxhetor afatmesem te njesive te qeverisjes vendore" i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Libohovë, në mbledhjen e datës 29.09.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

I. Të miratojë Raportin 8-mujor te Monitorimit Të Zbatimit Të Buxhetit për vitin 2026.

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë.

III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

JURIST
KRISTAQ CIKO

SHEF. SEK FINANCIAR
Joana Memo

KRYETARI
LEONARD HIDE

BASHKIA LIBOHOVË

REPUBLIKA E SHQIPËRI SË
BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

RELACION

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 57/2016, miratuar në datën 2.6.2016, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ligjit nr Nr. 115/2024, dtë ligjit nr Nr. 115/2024, "Për Buxhetin e vitit 2025",te Udhezimit Nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standade të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" gjeni anekset e raportit 8-mujor te monitorimit të buxhetit 2026.

Të ardhurat nga burimet e vete jane realizuar në masën 75.3%
Shpenzimet per paga realizuar ne masën 87.5 % ndaj buxhetit total per pagat, dhe 80.7 % te buxhetit progresiv. Shpenzimet për sigurime 88.4% te totalit te buxhetit per sigurime dhe 82.1 te buxhetit progresiv; shpenzimet operative 40.2% te totalit te buxhetit per shpenzime operative dhe , ndihma ekonomike në masën 94%.
Pagat dhe shpërblimet (600) janë realizuar në masën 87.5%, ndërsa kontributet e sigurimeve shoqërore (601) në masën 88.4%, duke paraqitur një nivel të mirë realizimi.
Mallrat dhe shërbimet (602) kanë realizim 40.2%. Realizimi ndryshon sipas zërave, ku shpenzimet për energji/materiale të caktuara paraqesin nivele më të larta, ndërsa disa zëra kanë realizim të ulët ose zero.
PAK paraqet realizim të lartë, rreth 94%, duke treguar se fondet e planifikuara janë përdorur në pjesën më të madhe.
Në përgjithësi, realizimi financiar paraqitet i ndryshëm sipas kategorive të shpenzimeve dhe lidhet me natyrën e tyre, afatet e prokurimeve dhe realizimin e aktiviteteve. Për zërat me realizim të ulët do të vijojë monitorimi me qëllim realizimin e fondeve të planifikuara deri në fund të vitit.

Në kuadër të zbatimit të investimeve të parashikuara në buxhetin e Bashkisë, për disa nga projektet e planifikuara është shpallur fituesi dhe procedurat ndodhen në fazën e lidhjes së kontratës.
Konkretisht, bëhet fjalë për:
Blerjen e kontenierëve;
Blerjen e tapetit të barit për fushën sportive në Nepravishtë;
Blerjen e autobetonieres;
Restaurimin e çatisë së Labovës;
Ndërtimin e këndit të lojërave

Për të garantuar realizimin e plotë të buxhetit dhe minimizimin e risqeve financiare, do të ndërmerren këto masa:

a) Monitorimi i vazhdueshëm mujor i realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve;
b) Forcimi i mbledhjes së të ardhurave vendore dhe ndjekja e debitorëve;
c) Kontrolli i shpenzimeve operative dhe përdorimi me eficiencë i fondeve publike;
d) Kufizimi i shpenzimeve jo prioritare;
e) Vijimi i procedurave për likuidimin e investimeve të përfunduara menjëherë .
f) Rishikimi i buxhetit sipas nevojës dhe propozimi i ndryshimeve buxhetore kur kjo të jetë e nevojshme;
g) Garantimi i disiplinës financiare dhe respektimi i afateve të pagesave ndaj operatorëve ekonomikë.

Propozojmë miratimin e raportit të monitorimit !

Me konsideratë të lartë !

SHEF SEK. ZHEMF
Joana Memo

REPUBLIKA E SHQIPËRI SË

BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr.2150 _prot **Libohovë më06.10.2026**

VENDIM

Nr. 54 , Datë 29 .09.2026

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Bazuar ne vendimin nr. 955, datë 07.12.2016" Për përcaktimin e kritereve , të proçedurave, dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike" , në udhëzimin nr.5,datë 17.02.2017."Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", në udhëzimin nr 4 datë 17.02.2017 " Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike" Ligjin 57/2019"Për asistencën sociale në RSH",VKB Libohovë, nr.3datë 24.01.2026 "Për përcaktimin e kritereve për familjet në nevojë" ,mbështetur në vlerësimin ekonomiko –social,propozojmë Këshillit Bashkiak ,për muajin gusht 2026, familjet që do të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6%.

VENDOSI

I.Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i 6%, për familjet e mëposhtme,për muajin Gusht 2026

Nr	Emri Atesia Mbiemri	Muaji	Shuma/lek
1	Ferdi Sejfulla Ruli	GUSHT 2026	2178

II.Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndihmes Ekonomike.

III.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I KËSHILLI
Rahim Skënderi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

KRYETARI I KËSHILLIT
Asim Banushaj

Miratuar me 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Pro : 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnnjë
Vota Abstenim :asnjë

Adresa: Lagjia "Tanua" Libohovë, email-bashkialiboh:ve@outlook.com, Tel: 00355 881 220 91

REPUBLIKA E SHQIPËRI SË

BASHKIA LIBOHOVË
SEKTORI I KULTURËS ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. **Prot** **Libohovë ,më 14.09.2026**

PROJEKT- VENDIM
Nr 8 datë, 14/09/2026

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI 6% PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Bazuar në vendimin nr. 955, datë 07.12.2016" Për përcaktimin e kritereve , të proçedurave, dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike" , në udhëzimin nr.5,datë 17.02.2017."Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", në udhëzimin nr 4 datë 17.02.2017 " Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike" Ligjin 57/2019"Për asistencën sociale në RSH",VKB Libohovë, nr.3datë 24.01.2025 "Për përcaktimin e kritereve për familjet në nevojë" ,mbështetur në vlerësimin ekonomiko –social,
Ppropozojmë Këshillit Bashkiak ,për muajin gusht 2026, familjet që do të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6%.

Nr	**Emri Atesia Mbiemri**	**Muaji**	**Shuma/lek**
1	Ferdi Sejfulla Ruli	GUSHT 2026	2178

Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndihmes Ekonomike.
Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër.

Sektori Shërbimit Social
Majlinda Gjika

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LIBOHOVË

KRYETARI
Leonard HIDE

Juristi
Kristaq Ciko

REPUBLIKA E SHQIPËRI SË

BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr.251 prot

Libohovë më 06.10.2026

VENDIM

Nr. 55 , Datë 29 .09.2026

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I VETË BASHKISË PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Duke u mbështetur në nenin 27/1 të Ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar me Ligjin 44/2016 datë 21.04.2016 , në pikën 7 të Kreut II të Vendimit nr.955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", ndryshuar me VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"Ligjin 57/2019"Për asistencën sociale në RSH",VKB Libohovë, nr.3 datë 26.01.2026 "Për përcaktimin e kritereve për familjet në nevojë" në bazë të propozimit të paraqitur nga zyra e Ndihmës Ekonomike ,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Libohovë , familjet në nevojë që kane dale jo fitues nga skema e ndihmës ekonomike, të perfitojnë ndihmë (në lekë) nga fondet e Pushtetit Lokal .

VENDOSI

I.Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i akorduar nga Bashkia, për familjet e mëposhtme,për muajin Gusht 2026

	Emer,mbiemer	Arsyet	LEKE
1	Josif Proko	Person i vetëm, jeton në Zagorie	5000
2	Marika Mino	Person i vetëm, jeton në Zagorie	5000
3	Vilson Buzo	Prind i vetëm me 3 fëmijë të mitur	5000
4	Ferdi Ruli	Person i vetëm ,I paaftë për punë	3000
5	Gjergji Ruli	Person i I paaftë për punë	5000
6	Fredi Proko	Person i I paaftë për punë	5000

Adresa: Lagjia "Linua" Libohovë, email-bashkialibohove@outlook.com, Tel: 00355 881 220 91

7	Zenel Çohani	Kryefamiljar ne nevojë	5000
8	Fikkeleda Manushi	Prind i vetëm me fëmijë të mitur	5000
9	Madrit Avdyli	Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur	5000
10	Resul Sinani	Person i I paaftë për punë	5000
11	Shqipone Myftaraj	Prind i vetëm me 2 fëmijë të mitur	5000
12	Aferdita Mërtiri	Person i vetëm, jeton në Zagorie	5000
13	Rigels Ruli	Kryefamiljar ne nevojë	5000
14	Niko Karavidha	Person i paaftë për punë	5000
15	Vladimir Zeneli	Kryefamiljar ne nevojë	5000
16	Gani Ruçi	Prind i vetëm me 1 fëmijë të mitur	5000
17	Bastri Buzo	Kryefamiljar ne nevojë	5000
18	Mirjana Çaushi	Kryefamiljar ne nevojë	

II.Për zbatim të këtij vendimi ngarkohet Zyra e Ndihmës Ekonomike.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I KËSHILLI
Rahim Shënderi

KRYETARI I KËSHILLIT
Asim Banushaj

Miratuar me 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Pro : 13 (trembëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnnjë
Vota Abstenim :asnjë

Adresa: Lagjia "Linua" Libohovë, email-bashkialibohove@outlook.com, Tel: 00355 881 220 91

REPUBLIKA E SHQIPËRI SË

BASHKIA LIBOHOVË

SEKTORI I KULTURËS ARSIMIT DHE MIRËQËNIES SOCIALE

Nr. Prot.

Libohovë më 14.09.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr 08 datë 14/09/2026

PROPOZIM PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I VETË BASHKISË PËR FAMILJET JO FITUESE NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE.

Duke u mbështetur në nenin 27/1 të Ligjit 9355, datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" i ndryshuar me Ligjin 44/2016 datë 21.04.2016 , në pikën 7 të Kreut II të Vendimit nr.955, datë 07.12.2016 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", ndryshuar me VKM nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"Ligjin 57/2019"Për asistencën sociale në RSH",VKB Libohovë, nr.3 datë 26.01.2026 "Për përcaktimin e kritereve për familjet në nevojë" në bazë të propozimit të paraqitur nga zyra e Ndihmës Ekonomike ,miratuar nga Kryetari i Bashkisë Libohovë , familjet në nevojë që kane dale jo fitues nga skema e ndihmës ekonomike, të perfitojnë ndihmë (në lekë) nga fondet e Pushtetit Lokal .

Propozojmë Këshillit Bashkiak.

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i akorduar nga bashkia familjet e mëposhtme,për muajin GUSHT 2026.

	Emer,mbiemer	Arsyet	LEKE
1	Josif Proko	Person i vetëm, jeton në Zagorie	5000
2	Marika Mino	Person i vetëm, jeton në Zagorie	5000
3	Vilson Buzo	Prind i vetëm me 3 fëmijë të mitur	5000
4	Ferdi Ruli	Person i vetëm ,I paaftë për punë	3000
5	Gjergji Ruli	Person i I paaftë për punë	5000
6	Fredi Proko	Person i I paaftë për punë	5000
7	Zenel Çobani	Kryefamiljar ne nevojë	5000